



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



PROKURORIA THEMELORE FERIZAJ/
OSNOVNO TUŽILAŠTVO U UROSEVAC/ BASIC PROSECUTION IN FERIZAJ



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË FERIZAJ

Janar – Mars 2025

Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, për periudhën kohore Janar-Mars 2025

Prokuroria e Ferizajt gjatë vitit 2024 ka ngritur 231 aktakuza për veprën penale “Dhuna në familje”

Ferizaj, 13 Janar 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, gjatë vitit 2024, ka pranuar dyqind e shtatëdhjetë e pesë (275) kallëzime penale kundër dyqind e shtatëdhjetë e pesë (275) personave lidhur me veprat penale të dhunës në familje.

Ndërsa, gjatë vitit 2024, nga kjo prokurori janë ngritur dyqind e tridhjetë e një (231) akte akuzuese për veprat penale të dhunës në familje dhe dyqind e katërmëdhjetë (214) viktima kanë qenë të gjinisë femërore dhe gjashtëdhjetë e një (61) të gjinisë mashkullore.

Po ashtu, gjatë vitit 2024, janë parashtruar pesëdhjetë e gjashtë (56) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën kompetente.

Prokuroria Themelore në Ferizaj, do të vazhdojë t'i trajtoj me seriozitet të gjitha rastet e dhunës në familje, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të parandaluar dhe luftuar veprat penale të kësaj natyre.

Prokuroria Themelore në Ferizaj

Prokuroria e Ferizajt gjatë vitit 2024 ka ngritur
231 aktakuza për veprën penale “Dhuna në
familje”



Mbahet takim koordinues për veprat penale kundër Dhunës në familje

Ferizaj, 17 Janar 2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, z.Burim Çerkini, sot gjatë ditës ka mbajtur takim në Prokurorinë Themelore në Ferizaj me znj.Laura Pula- prokurore koordinatorë për rastet e dhunës në familje nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, z.Burhan Maxhuni- U.D.Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) dhe zyrtarë tjerë nga kjo zyrë Qendrore në Prishtinë dhe zyrtarë nga ZMNV në Ferizaj, si z.Avdullah Abedini- prokuror koordinator për rastet e dhunës në familje nga Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie.

Gjatë këtij takimi nga të pranishmit u diskutua lidhur me trajtimin e rasteve të veprat penale kundër dhunës në familje dhe bashkëpunimit dhe koordinimit mes Prokurorisë, Policisë dhe Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), me qëllim të harmonizimit të veprimeve për trajtimin sa më efikas dhe zgjidhjen e rasteve të kësaj natyre.

Krejt në fund të pranishmit u dakorduan që bashkëpunimi mes tyre të vazhdoj duke u mbajtur këto takime të rregullta me qëllim të trajtimit në mënyrë të drejtë dhe efikase të rasteve të dhunës në familje.



Kërkohej paraburgim për veprën penale “Vrasja në tentativë”

Ferizaj, 27 Janar 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj të dyshuarve N.D., dhe E.P., për shkak të dyshimit të veprës penale “Vrasja në tentativë” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se më 25 janar 2025, rreth orës 17:05, në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, pas një mosmarëveshje në komunikacion, të pandehurit për të u sqaruar hynë në automjetin e të dëmtuarit L.Q., dhe gjatë rrugës brenda veturës, të pandehurit e sulmojnë të dëmtuarin L.Q., e pastaj përleshja vazhdon edhe jashtë veture ku në një moment i pandehuri N.D., nxjerr një thikë nga xhepi dhe me dashje që ta privon nga jeta e godet të dëmtuarin disa herë në pjesë abdominale duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe dy të pandehurit largohen nga vendi i ngjarjes, ndërsa i dëmtuari fillimisht dërgohet në Emergjencën e Ferizajt pastaj dërgohet në QKUK-Prishtinë, ku i nënshtrohet operimit, me çka

në bashkëkryerje kryen veprën penale "Vrasja në tentativë" nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Të pandehurit që nga data 25 Janar 2025, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh për veprën penale të lartëcekur.



Kryeprokurori Çerkini priti në takim drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Ferizaj dhe komandantët e stacioneve policore të rajonit të Ferizajt

Ferizaj, 30 Janar 2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, z.Burim Çerkini, sot gjatë ditës ka mbajtur takim me drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Ferizaj z. Faton Pllana, së bashku me komandantët e të gjitha stacioneve policore të rajonit të Ferizajt, si dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Në këtë takim i pranishëm ishte edhe prokurori nga Departamenti për të Mitur i kësaj prokurorie, z. Agim Kuka.

Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me koordinimin dhe ngritjen e bashkëpunimit në mes Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe Policisë, si dhe për problemet dhe sfidat e mundshme gjatë punës së përditshme.

Kryeprokurori Çerkini, kërkoi nga të pranishmit koordinim dhe bashkëpunim sa i përket trajtimit të çështjeve të ndryshme penale me qëllim të parandalimit të tyre dhe ofrimit të sigurisë për qytetarët e vendit.

Pikë diskutimi nga të pranishmit ishte edhe procesi zgjedhor dhe të njëjtit u dakorduan që në bazë të kompetencave të tyre të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, me qëllim të mbrojtjes së votes së qytetarëve.

Në fund të këtij takimi, të pranishmit u pajtuan për bashkëpunim të mëtutjeshëm mes vete.



Ndalohet një person i dyshuar për veprën penale “Vrasja e rëndë”

Ferizaj, 05 Shkurt 2025


Prokuroria Themelore në Ferizaj, njofton opinionin publik se me vendim të Prokurorit të Shtetit, ka ndaluar në kohëzgjatje prej 48-orësh, të dyshuarin me initiale L.F., për shkak të dyshimit të

veprës penale “Vrasja e rëndë” nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas hetimeve të ndërmarra nga ana e hetuesve rajonal të Policisë së Kosovës në koordinim me Prokurorin e Shtetit, është arritur të identifikohet dhe ndalohej i dyshuari L.F., lidhur me rastin kur fillimisht një person me inicialet B.V., është raportuar i zhdukur nga familjarët e tij dhe sot më datën 05 Shkurt 2025, është gjetur trupi i pajetë i të ndjerit B.V., në malet e fshatit Manastirc të komunës së Ferizajt.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, trupi i pajetë i viktimës është dërguar për obduksion në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë (IML).

Prokuroria Themelore në Ferizaj në koordinim me Policinë, është duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim të zbardhjes së gjitha rrethanave lidhur me këtë çështje penale.




Kërkohet paraburgim për veprën penale “Vrasja e rëndë”

Ferizaj, 6 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj të dyshuarit F.L., nga fshati Pleshinë e Ulët-Komuna Ferizaj, për shkak të dyshimit të veprës penale “Vrasje e rëndë” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se më datë 23.01.2025, në orët e pasdites, në malet e fshatit Manastirc të komunës së Ferizaj, i pandehuri F.L., në mënyrë mizore dhe për motive ende të panjohura ka privuar nga jeta viktimën B.V., dhe i njëjti më pas e gropos viktimën në një vend në mal, me qëllim të fshehjes dhe zhdukjes së gjurmëve dhe largohet nga vendi i ngjarjes, kurse më datë 05.02.2025 nga disa persona të fshatit Manastirc gjendet trupi i pajetë i viktimës B.V. me të cilën do të kryente veprën penale “Vrasje e rëndë” neni 173 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së.

I pandehuri F.L., që nga data 5 Shkurt 2025, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh për veprën penale të lartëcekur.



Ndalohet një person i dyshuar për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit”

Ferizaj, 20 Shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, njofton opinionin publik se me vendim të Prokurorit të Shtetit për Krime të Rënda, ka ndaluar në kohëzgjatje prej 48-orësh, të dyshuarin me initiale A.L., për shkak të dyshimit të veprës penale “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 424 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ndaj të dyshuarit të lartëpërmendur, do të vazhdojë me procedura të mëtejme hetimore.



Kërkohet paraburgim për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit”

Ferizaj, 20 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30

ditësh ndaj të dyshuarit A.L.,-nga komuna e Pejës, për shkak të dyshimit të veprës penale “Ushtrimi i ndikimit” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se me datë 17.03.2023, në Prishtinë, i pandehuri A.L., në mënyrë të drejtpërdrejtë ka kërkuar para për vete që të ushtroj ndikim të padrejtë në vendimarrjen e personit zyrtar, në atë mënyrë që pas arrestimit të të pandehurit E.S., dhe caktimit të paraburgimit nga ana e gjykatës, është takuar me vëllain e të pandehurit, prej të cilit ka kërkuar dyzet mijë (40.000) euro para që të ushtroj ndikim të padrejtë në vendimarrjen e personave zyrtar, gjyqtarë e prokurorë për ta liruar nga paraburgimi të pandehurin E.S., cili gjendej në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, për shkak të dyshimit të bazuar të veprave penale “Fajdeja “ dhe “Shmangia nga tatimi” të KPRK-së edhe pse ndikimi i supozuar nuk është realizuar andaj, me këtë i pandehuri A.L., do të kryente veprën penale “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 424 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I pandehuri A.L., që nga data 19 Shkurt 2025, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh për veprën penale të lartëcekur.




Kërkohet paraburgim ndaj të dyshuarit për shitblerje të narkotikëve

Ferizaj, 25 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj të dyshuarit A.U., nga Ferizaj, për shkak të dyshimit të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se më datë 24.02.2025, në Ferizaj, konkretisht në banesën ku jeton, i pandehuri, pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes substancë narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyrë që pas kontrollit nga ana e Njësitit Anti-drogë në dhomën e tij janë gjetur dyzetë e dy (42) qese najloni me substancë narkotike të llojit marihuanë dhe një kavanoz qelqi e cila ishte e mbushur me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 95.86 gram. Po ashtu, të njëjtit i është gjetur një peshore digjitale dhe të holla në vlerë totale njëqind e njëmbëdhjetë (111) euro, të cilat janë sekuestruar nga policia, me çka do të kryente veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

I pandehuri A.U., që nga data 24 Shkurt 2025, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh për veprën penale të lartëcekur.



Kërkohet paraburgim për veprat penale “Kontrabandim me mallra” dhe “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

Ferizaj, 28 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj të dyshuarve me initiale M.B., dhe M.B.,- nga Fsh.Bllacë-Republika e Maqedonisë së Veriut,- shtetas të Republikës së Kosovës, për shkak të dyshimit të veprave penale “Kontrabandim me mallra dhe “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se 26 shkurt 2025, rreth orës 21.00, me dashje në bashkëkryerje, të njëjtit, kanë tentuar të kalojnë vijën kufitare nga Republika e Kosovës për në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në atë mënyrë që kanë shmangur kontrollin doganorë, ashtu që me veturën “VW Sharan”, ngjyrë e zezë, në të cilën kanë pas të ngarkuara mallra të ndryshme- veshmbathje, mirëpo në fsh. Krivenik, 200 m pa mbërri tek vija kufitare, janë vërejtur nga policia të cilët kanë arritur që ti ndalin, me këtë do të kryenin veprën penale

Kontrabandimi i mallrave në tentativë dhe bashkëkryerje nga neni 311 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, ekziston dyshimi i bazuar se me datë, kohë dhe vende të njëjtë si në pikën I të dispozitivit, në bashkëkryerje me dashje dhe me forcë kanë penguar personat zyrtar – zyrtarët policor në lidhje me detyrat e tyre zyrtare, në atë mënyrë që derisa personat zyrtarë ishin duke kryer detyrat e tyre në një pikë vëzhgimi afër vijës kufitare Republika e Kosovës për në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kanë vërejtur të pandehurit me veturën “VW Sharan” duke kaluar vijë kufitare, dhe i kanë sinjalizuar që të ndalen, mirëpo të njëjtit nisin veturën me vrull me qëllim për ta goditur zyrtarin policor A.Rr., që ishte jashtë veturës, i cili detyrohet që të përdorë armën e tij zyrtare në vetëmbrojtje, duke bërë që vetura të merr drejtim tjetër të ikjes, ashtu që zyrtarët i vihen pas në ndjekje dhe arrijnë që të ndalin veturën e të pandehurve. Mirëpo, të pandehurit gjatë arrestimit kanë rezistuar duke sulmuar zyrtarët policor, me ç’ rast tretman mjekësor për shkak të lëndimeve kanë marr zyrtarët A.R dhe Sh.M, me të cilën do të kryenin veprën penale në bashkëkryerje “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 paragrafi 5 lidhur me paragrafi 4 dhe 1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Të pandehurit M.B., dhe M.B., që nga data 26 Shkurt 2025, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh për veprat penale të lartëcekura.



Kërkohet paraburgim ndaj të dyshuarit për vepën penale “Ngacmimi”

Ferizaj, 10 Mars 2025 –

Prokuroria Themelore në Ferizaj, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj të dyshuarit K.S.,nga Peja, për shkak të dyshimit të veprës penale “Ngacmimi” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se gjatë vitit 2025, në komunën e Shtimes, i pandehuri me dashje dhe në vazhdimësi është përfshirë në sjellje të vëmendjes së padëshirueshme, duke e vënë nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit të dëmtuarën V.Z., me të cilën ka qenë në lidhje dashurie, në atë mënyrë që në veturën e saj personale ka vendosur dy GPS për përcjellje të vendndodhjes dhe i ka hapur llogari në rrjetin social “Instagram”, në emër të dëmtuarës, duke postuar fotografi të ndryshme, me mbishkrime denigruese, dhe duke paraqitur se e njëjta ofron shërbime seksuale me pagesë, duke ia paraqitur edhe numrin e telefonit, dhe adresën e banimit, e që si rrjedhojë e këtyre veprimeve të dëmtuarën e ka vë nën shqetësim të madh emocional, me të cilën ka kryer veprën penale “Ngacmimi” nga neni 182 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

I pandehuri K.S.,që nga data 08 Mars 2025, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh për veprën penale të lartëcekur.



Kërkohet paraburgim ndaj dy të dyshuarve për vepën penale “Trafikimi me njerëz”


Ferizaj, 17 Mars 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj të dyshuarve E.S.,- Lipjan dhe V.H.,- komuna Ferizaj, për shkak të dyshimit të veprës penale “Trafikimi me njerëz” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se muaji gusht i vitit 2024 e deri me datën 15.03.2025, në magjistralen Ferizaj-Prishtinë pn, të pandehurit në bashkëkryerje me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, në vazhdimësi, marrin pjesë në trafikimin e njerëzve, në atë mënyrë që e pandehura V.H., në koordinim të plotë edhe me të pandehurin E.S., përmes kanosjes apo përdorimit të forcës, duke bashkëpunuar me pronarin faktik të villave, sipas kërkesave të klientëve të tyre iu ofrojnë femra për shërbime seksuale, saktësisht duke u siguruar të njëjtave klientë të ndryshëm me të cilët bën marrëveshje që të

kryejnë marrëdhënie seksuale në këmbim të parave, e të cilat para të pandehurit i përvetësojnë për vete, me këtë kishin për të kryer veprën penale në bashkëkryerje dhe në vazhdim “Trafikimi me njerëz” nga neni 165 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Të pandehurit që nga data 15 Mars 2025, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh për veprën penale të lartëcekur.



Ndalohet një person për veprën penale “Dhunimi”

Ferizaj, 26 mars 2025

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për të Mitur, njofton opinionin publik se pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, në koordinim me Policinë e Kosovës, është ndaluar i pandehuri me inicialet E.H.

Prokurori i Shtetit njofton se i pandehuri E.H. është ndaluar në lidhje me rastin e dhunimit të një të miture të moshës 14-16 vjeçare në Ferizaj, për dyshimin se ka kryer veprën penale

"Dhunimi", sipas nenit 227, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, Prokurori i Shtetit do të paraqesë kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj brenda afatit të parashikuar.

